

## REDAKSIA

### Kryeredaktorë:

Zanë Buçinca  
Blerina Zhitija

### Redaktorë përgjegjës:

Arrita Rezniaqi  
Rozafa Maliqi  
Rudina Morina

### Disejani:

Zanë Buçinca

### Anëtarë të redaksisë:

Andi Selimi  
Bardha Çollaku  
Donika Kryeziu  
Diellza Dobroshi  
Diora Binxhiu  
Gentiana Demaj  
Leonora Beqiri  
Luljeta Krasniqi  
Njomëza Beqiri  
Rineta Zeka  
Zana Beqa  
Xheva Govori

## Spektakël i bukur shkollor


Të nxitur nga ëndrrat, pasioni, prirjet veçanta për muzikën dhe dëshira për të shfaqur shpirtin artistik, disa nxënës të talentuara në muzikë, me ndihmën e arsimtares së muzikës Yllnora Limani arritën të japin një shfaqje muzikore që lirisht mund të quhej spektakël muzikor. Kjo shfaqje ishte njëherësh një pikënisje për realizimin e ëndrrave të tyre, të cilat mund të bëhen realitet në të ardhmen. Këtë më së miri e dëshmoi paraqitja e tyre para nxënësve. Hapjen e këtij spektakli të bukur shkollor e bëri Vala në interpretimin e këngës **Be good to me** e më pas edhe Mjellma me këngën **Unfaithful**. Vala dhe Mjellma përveç interpretimit solo, kënduan një këngë në duet e cila filloi ta ndezë atmosferën. Pas këtij interpretimi të bukur doli në skenë Zhaneta me këngën e Christina Aguilers, **Hurt**. Një këngë tjetër balade të titulluar **My immortal** e këndoi Adea. Një tjetër këngë të bukur që i kushtohej personit më të dashur në botë nënës, e këndoi Nita me zërin e saj melodik dhe premtues.

Duke dëshmuar që arritja në një fushë të caktuar kërkon përkushtim, më së miri, këtë përkushtim për këngën e paraqiti zëmblla dhe simpatikja Dua me këngët **Nobody's wife** dhe **No one**. Gjithçka doli të jetë bukur dhe origjinale. Këtë origjinalitet e bukuri e vazhduan Nita me Duan me këngën **Infatuation**. Për t'i dhënë bukuri dhe forcë këtij spektakli duke mishëruar ndjenjat për këngën, në interpretim grupor, Nita, Dua, Vala dhe Mjellma sollën para nxënësve këngën **Bleeding Love**. Për atmosferën dhe interpretimin e tyre të mrekullueshëm, nxënësit, në shenjë falënderimi, për shoqet e tyre, duartrokiten dhe përgëzuan talentet e ardhshëm të muzikës.



## Vizitë në kështjellën e Artanës

Vizitat tona po bëhen gjithnjë e më interesante, vizita e radhës ishte Gjilani. Derisa po udhëtonim pamë minierën e Kishnicës, aty afër ishte edhe penda e lumit. Ndalesa e parë ishte në qytetin e Artanës, një vend i bukur dhe i lashtë i rrethuar me male dhe bregore. Në majë të kodrës gjendej kalaja e bukur e Artanës, e cila edhe pse dukej e rrënuar fshihte në vete bukuritë dhe madhështinë. Rrënojat ishin një tregues për qytetin e vjetër të Artanës. Toka e cila gjendej rreth kështjellës thuhet se është e pasur me xehe. Sipas të dhënave të kësaj kohe në vitin 1945 u zhvillua miniera e parë e cila ishte e pasur me ar, zink dhe plumb. Ata nxirrnin 6000 kg argjend në vit. Gjithashtu në Novobërdë janë gjetur edhe fragmente të qeramikës dhe monedha bronzi të periudhave të ndryshme, që nga periudha e bronzit dhe e hekurit nga shekulli 3-të dhe 4-të i erës së re. E gjithë kjo tregon se qyteti ishte i ngritur mbi bërthamën e një vendbanimi apo qyteti antik. Në mesin e objekteve të shekullit të 14-të shquhet Katedralja apo Bazilika e ndërtuar mbi themelet e një tempulli antik nga shekulli i 4-të para erës së re. Pamë edhe një xhami të vjetër të ndërtuar nga Turqit. Gjithashtu patëm rastin të shihnim edhe Tyrben, në të cilën vizitorët që e vizitonin linin bakshishe të ndryshme, si një ritual, të cilit i besonin dhe mendonin se mund të kishin më shumë fat në jetë. Ndalesën tjetër e bëmë në qytetin e Gjilanit, aty vizituam fabrikën e bukës Kualiteti. Udhëheqësit e kësaj fabrike na mirëpritën me dashamirësi, përgatitën një drekë të shijshme për ne e më pas vizituam fabrikën dhe u njoftuam me ecurinë e prodhimit të bukës dhe mjetet e punës. Kjo ishte një vizitë që po na bënte të ndjeheshim më kureshtarë dhe të kuptonim se sa e rëndësishme është prodhimi i bukës, që ka rëndësi jetësore për njeriun.



## Informacione të shkurtra nga cikli I ulët

Nxënësit e klasave të dyta më datë 4 prill 2008 kanë realizuar vizitë në lulishten Agrocoop Shtime. Qëllimi i vizitës: Mbjellja dhe kujdesi ndaj bimëve e në veçanti për lulet.

Nxënësit e klasave të para dhe të dyta realizuan një shëtitje në parkun Gërmia më datë 30 prill 2008.

Qëllimi i vizitës: Ndryshimet në natyrë.

Nxënësit e klasave të treta realizuan Projektin: Pak kujdes shumë shëndet më 30 prill 2008. Ata përpos prezantimeve përmes kompjuterit punuan edhe vizatime, shkrime dhe punime të ndryshme nga pemët, perimet dhe drithërat.

## Vizitë me rëndësi në Amerikë

Pas ftesës që mori, arsimtarja e gjuhës angleze Fitore Hoxha, gjatë dy javëve të para të prillit qëndroi në ShBA. Atje mori pjesë në dy programe të ndryshme të organizuara lidhur me mësimdhënien e gjuhës angleze.

Gjatë javës së parë qëndroi në New York City, ku mori pjesë në një Konferencë të organizuar nga TESOL (Teachers of English to Speakers of Other Languages). Në këtë konferencë kishte mbi 10 000 pjesëmarrës. Aty u prezantuan punime të ndryshme nga mësimdhënës dhe drejtues të programeve të ndryshme lidhur me gjuhën angleze. Arsimtarja bashkë me pesë mësimdhënës të tjerë, dy prej të cilëve ishin specialistë të Gjuhës Angleze Mary Lou McCloskey nga Georgia dhe Lydia Stack nga San Francisco, Drejtuesi i RELO (Zyra Rajonale për Gjuhë Angleze) Gergo Santha në Budapest, Hungari dhe dy mësimdhënës të gjuhës angleze Daniela Petrescu nga Rumania dhe Bernadett Bozsa nga Hungaria prezantuan së bashku **Building Communities Language Development (Ndërtimi i gjuhëve në komunitete)**. Pas vizitës, projekti tregoi aktivitetet dhe punën tonë në shkollë, e cila ishte realizuar gjatë Kampit Veror në Hungari, në të cilin, vitin e kaluar, morën pjesë, përveç arsimtares edhe pesë nxënës nga shkolla jonë.

Gjatë ditëve të konferencës në New York, po ashtu ishte i hapur edhe një panair i librit. Në këtë panair kishte përfaqësi të shtëpive botuese të librave dhe programeve të ndryshme të gjuhës angleze pothuaj nga e tërë bota.

Java e dytë filloi me një program më ndryshe nga ai i pari. Së bashku në një grup që përbëhej nga 10 vetë nga vende të ndryshme të botës vizitoi edhe Santa Fe, New Mexico dhe Denver, Colorado. Fokusi i programit ishte Sistemi Arsimor Dygjuhësor. Kishte vizituar edhe disa shkolla fillore, të mesme si dhe universitete në të cilat kishte parë se si zhvillohej mësimi, me risi, të cilat tashmë ka filluar t'i zbatojë me disa nga klasat, shtoi arsimtarja e gjuhës angleze Fitore Hoxha-Saliu.

## Vizita kthyesë e mësueseve amerikane


Pas vizitës së bërë nga arsimtarja në ShBA, tri mësuese po nga ShBA-ja vizituan shkollën tonë për t'u njohur më për së afërmi me mësimin e rregullt dhe aktivitetet që zhvillohen në shkollën tonë. Së bashku me arsimtaren e gjuhës angleze ato kishin planifikuar që gjatë orëve të studimit të ishin të pranishme dhe të komunikojnë me nxënës në gjuhën angleze, duke zhvilluar disa aktivitete interesante me ta. Kjo gjë doli shumë bukur pasi që fëmijët u ndanë shumë të kënaqur dhe u befasuan me mënyrën se si komunikonin dhe zhvillonin aktivitetet këto mësuese. Por edhe mësueset kishin fjalë miradije për nxënësit. Ishte një moment i mirë për t'u njohur me përvoja të reja, një moment i cili premtan se shkolla është e hapur për përvoja të reja dhe bashkëpunime me shkollat jashtë vendit, me qëllim të shkëmbimit të përvojave, bashkëpunimit dhe integritit me fëmijët e botës, pa përjashtim.



## Klubi I futbollit

Qëllimi i këtij klubi është që t'i ngrejë vlerat edukative fiziologjike dhe psikomotorike të fëmijëve që janë në këtë grup. Aktivitetet të cilat janë zhvilluar që nga formimi i klubit janë stërvitjet e llojeve të ndryshme, që nga ato që e rrisin kohezionin në këtë grup e deri te ato tekniko-taktike të lojës së futbollit.

Dobia e këtyre aktiviteteve është e shumëfishtë, pasi që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve funksionale të organizmit, dobinë edukative, arsimore dhe sociale. Priten të zhvillohen takime dhe ndeshje futbollit me nxënësit e shkollave tjera.



## Klubi Harry Potter

Formimi i këtij klubi ka karakter edukativ dhe në të njëjtën kohë ndihmon në fitimin e njohurive tjera, përveç mësimin të rregullt. Që nga formimi i këtij klubi nxënësit kanë lexuar vepra të ndryshme në gjuhën angleze dhe i kanë komentuar ato dhe në disa raste kanë shkruar tema të ndryshme të zgjedhura nga vetë nxënësit. Ka raste kur shfaqet ndonjë film dhe më pas diskutohet për përmbajtjen e atij filmi apo dokumentari, më qëllim të përvetësimit të kulturës së të folurit.

Në të ardhmen synohet të vizitohet ndonjë vend i huaj dhe të bëhet binjakëzimi me ndonjë shkollë që do të ndihmojë për rezultate më të mira.

## Klubi Inxhinierët

Qëllimi i këtij klubi është që në radhë të parë nxënësit të kënaqen e më pas të marrin njohuri për elektronikën. Disa nga aktivitetet që janë zhvilluar janë matjet e disa madhësive elektrike, realizimi i disa qarqeve si dhe një vizitë e bërë përfaqësuesit të teknikës së bardhë Gorenje. Me këto aktivitete dhe aktivitetet tjera në vazhdim ata do të fitojnë njohuri të reja.



## Klubi Goethe

Qëllimi i këtij klubi është që nxënësit pjesëmarrës të cilët janë kryesisht gjermanofolës të njihen me jetën dhe kulturën gjermane, por edhe më tej të përforcojnë njohuritë që lidhen me gjuhën gjermane. Që nga formimi i këtij klubi janë zhvilluar lojëra të ndryshme, janë lexuar tekste të ndryshme, janë komentuar e debatuar si dhe kemi parë edhe ndonjë film. Dobia e këtyre aktiviteteve është që nxënësit mësojnë më shumë gjëra, që nuk mund t'i mësojnë në mësimin e rregullt.

Nxënësit ndihen mjaft të kënaqur për vetë faktin që të gjitha këto aktivitete janë të përzgjedhura nga vetë nxënësit pjesëmarrës.

## Klubi Kuzhina dhe shëndeti

Qëllimi i këtij klubi është që nxënësit të aftësohen për gatimin e ushqimeve të ndryshme si gjella të ndryshme, sallata, ëmbëlsira etj. Disa nga aktivitetet që janë zhvilluar janë gatimi i gjellëve të ndryshme si gjella me spinaq, me mish peshku, brumëra si pitja, flija, petulla dhe ëmbëlsira të llojllojshme.

Nxënësit me sukses po gatuajnë dhe nganjëherë bëjnë ushqime të llojllojshme. Aktivitetet tjera që do të zhvillohen janë vizitat që do t'u bëhen restoranteve të ndryshme, për të parë se si përgatisin dhe për të pasur si model ndonjë recetë ushqimi. E bukur dhe interesante për ata që janë të dhënë pas ushqimit. Porosia e klubit është që të mos hamë shumë, sepse dihet, mund të trashemi, por ne nuk do t'i dëgjojmë përderisa ata gatuajnë kaq mirë.



## Klubi Arts & Crafts- Punë dore

Qëllimi i këtij projekti është që nxënësit të krijojnë shkathtësi dhe të njihen me punimet e dorës si ato me kërrabëza, pastaj suvenirët e ndryshme (byzlykë). Në vazhdimësi do të mendohet të punohen sa më shumë punë dore dhe ato të ekspozohen në pancaire shkollore. Nxënësit ndihen të kënaqur pasi që për ta këto aktivitete janë argëtuese dhe interesante.

## Klubi Kinemaja

Ka për qëllim të krijojë një lloj kinemaje brenda shkollës, në të cilin do të ketë një kartotekë me zhanre të ndryshme të kinemasë. Përveç kësaj nxënësit do të mësojnë se si bëhet skenari për film, dramë, komedi etj.

Disa nga aktivitetet të cilat janë zhvilluar janë transmetimi i filmit të metrazhit të gjatë, komentimi i tij me gojë dhe shkrim, pastaj të shkruarit e një skenari filmi duke pasur si model një skenar të njohur. Gjithashtu është shfaqur edhe një komedi, pastaj është komentuar dhe analizuar gjuha e aktorëve dhe komunikimi i tyre me publikun. Dobitë janë të shumëfishta, sepse ata tashmë po mësojnë se si shkruhet një skenar filmi, mësojnë më shumë për atë që i takon kinemasë duke përfshirë aktorët, lojës së tyre, si dhe përvetësimin e teknikave për të parë talentin e tyre, pa harruar edhe argëtimin si një pjesë të rëndësishme të elementeve.

Planet e këtij klubi janë që në një të ardhme të shpejtë të realizohet një film i metrazhit të shkurtër, pastaj përgatitja e një drame, vizita te ndonjë prej aktorëve të njohur shqiptarë si dhe vizitë ndonjë prej televizioneve për të parë se si punohet, transmetohet dhe realizohet një shfaqje televizive.

## Klubi Kostumografia

Qëllimi i formimit të këtij klubi është që nxënësit të njihen me ndryshimet dhe më të rejat në modë, dizajn dhe kostumografi. Veshja e kukullës në vizatim, katalogu personal janë disa nga aktivitetet të cilat i kanë zhvilluar nxënësit dhe kanë shfaqur kreativitetin e tyre për këtë lëmi. Parashihet që në veshje të ketë modele me motive kombëtare duke i vizituar dhe pasur si model shkollat profesionale të modës.



## Klubi Shahistët

Ky klub është formuar me kërkesën e nxënësve që të ushtrojnë lojën e shahut. Që nga formimi i këtij klubi, nxënësit vazhdimisht kanë luajtur njëri me tjetrin duke vënë në funksion lëvizjet e mësuara nga arsimtarët, por duke shfaqur edhe talentin e tyre.

Në këtë klub, nxënësit ushtrojnë lojën e shahut e cila zhvillon të menduarit më të thellë, koncentrimin dhe durimin. Do të organizohet një turne shahu me nxënësit pjesëmarrës në klub dhe do të zgjidhet shahisti më i mirë. Ata janë shumë të kënaqur me lojën e shahut, vijnë me shumë dëshirë dhe gjatë tërë kohës shkëmbejnë njohuri ndërmjet tyre.

Përveç këtyre klubeve në shkollën tonë funksionojnë edhe disa klube tjera, për të cilat do të shkruajmë në numrin e ardhshëm të Letrës Informative.



## Klubi Ndërmarrësia

Qëllimi i formimit të këtij klubi është: të mësuarit e Ndërmarrësisë.

Ndërmarrësia është një lëndë e re mësimore, e cila do të implementohet në të gjitha institucionet arsimore të Kosovës nga shtatori-tetori 2008.

Shkolla "M3" është shkolla e parë jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon, në të cilën ka filluar mësimdhënia dhe nxënia e kësaj lënde të re mësimore.

Nxënia e Ndërmarrësisë, do të kultivojë tek nxënësit kualitetet personale, siç janë kreativiteti, shpirti i iniciativës dhe pavarësisë, që kontribuojnë në zhvillimin e një qëndrimi për Ndërmarrësi, që do të dëshmojnë si të dobishme në jetën e tyre dhe në çdo aktivitet punues. Në këtë fazë, do të zhvillohen format autonome dhe aktive të mësimi. Për më tepër, ky mësim do të ofrojë njohuri fillestare dhe kontakte me botën e biznesit, dhe pjesë të të kuptuarit për rolin e ndërmarrësve në komunitet. Aktivitetet mund të përfshijnë punën në projekte, të mësuarit përmes lojës, prezantimin e studimeve të rasteve të thjeshta praktike dhe vizitat në ndërmarrjet vendore.

Për informacione më të hollësishme mund të klikoni në ueb faqen [www.edukimi.net](http://www.edukimi.net)

## Risi në aktivitete tona shkollore

Data 4. 4. 2008 ishte një ditë e bukur për nxënësit e klasave të katërta pasi që arsimtari i edukatës fizike Driton Mamaj kishte ftuar disa trajnerë së bashku me disa futbollistë të vegjël, lojtarë të shkollës së futbollit 2 Korriku. Fillimisht u ndanë nëpër stacione, u njohën me trajnerët dhe ecurinë e lojërave që do të zhvillonin. Secili grup kishte stacionin e vetë, gjithsej ishin katër stacione. Në secilin stacion zhvilloheshin lojëra të ndryshme dhe të bukura.

Pas përfundimit të lojërave të caktuara në një stacion, nxënësit bënë nga një pushim të shkurtër. Gjatë kësaj kohe ata dëgjonin muzikë të bukur të kënduar nga nxënësit e klasave të larta. Të vegjlit e klasave të katërta thanë që kaluan një kohë të këndshme, sepse kishin mësuar lojëra të reja, po praktikonin lojërat që i dinin dhe po shprehnin talentin e tyre me bashkëmoshatarët e tyre. Gjërat që mësuuan ishin se si ta ruanin ekuilibrin, si të mbroheshin nga të tjerët, kur ata sulmonin, si të udhëhiqnin me top, si të ishin më të saktë në gjuajtje etj.

Pas aktiviteteve të bukura nxënësit edhe pse ishin lodhur paksa kishin forcë të falënderonin arsimtarin Driton dhe kolegët e tij që organizuan këto lojëra të bukura sportive.



## Shkolla jonë në Panairin e Edukimit

Këto ditë shkolla Mileniumi i Tretë, së bashku me KEC-in, i është përgjigjur ftesës për pjesëmarrje në Panairin për Edukim dhe Biznes i mbajtur më 7 deri me datën 10 maj 2008 në Sallën e Kuqe në Prishtinë. Panairi në fjalë u organizua nga CEO-Congress Event Organization. Gjatë tri ditëve të panairit shkolla jonë prezantoi vlerat e saj përmes materialeve të ndryshme të përgatitura nga vetë nxënësit dhe arsimtarët e tyre. Materialet që shpërndareshin gjatë panairit ishin të karakterit propagandues dhe promovues. Përveç programeve dhe botimeve shumë të rëndësishme të KEC-it, një interesim të madh zgjuan edhe materialet e ndryshme të punuara nga nxënësit e kësaj shkolle, si: fletëpalosje, broshura, revista, punëdore të ngjashme etj.

Gjithashtu, gjatë këtij aktiviteti shkolla jonë pati mundësi të informojë pjesëmarrësit e ndryshëm për programin dhe filozofinë e shkollës, për mënyrat e vijimësisë së mësimi, për regjistrimin dhe pranimin e nxënësve në këtë shkollë etj.



## Foto nga aktivite të ndryshme



